

Sektorin e veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të neneve 31 dhe 37 të Rregullores së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, lidhur me zbatimin e nenit 114 të Ligjit për procedurë penale, në seancën e mbajtur më 07.12.2021, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë cenimin thelbësor të dispozitave të procedurës penale të nenit 415 paragrafi 1 pika 11 të Ligjit për procedurë penale, kur duke miratuar aktgjykim në bazë të pranimit të fajit në seancën kryesore nuk e ka thirrur të dëmtuarin për tu prononcuar lidhur me kërkesën juridike pronësore, kur dëmi është element kualifikues i esencës ligjore të veprës penale dhe as nuk ka disponuar prova tjera për kërkesën e dëmit.

A r s y e t i m

Në Sektorin e veprave penale, përmes Sektorit të praktikës gjyqësore të kësaj gjykate, është dorëzuar çështje juridike të Gjykatës së Apelit Shkup për vendimmarrje mbi kërkesë juridike pronësore e të dëmtuarit sipas nenit 114 të Ligjit për procedurë penale, gjatë vendimmarrjes së aktgjykimit në bazë të pranimit të fajit.

Gjykatat e Apelit Shkup, gjatë veprimit për lëndët në procedurë ankuese, konstaton se në procedurat e kryera në gjykatën e shkallës së parë me aktgjykim në bazë të pranimit të fajit, gjykatat e shkallës së parë pas dhënies së pranimit të fajit nga ana e të akuzuarit, pasi që t' i nxjerrin provat lidhur me vendimin e sanksionit penal, miratojnë aktgjykim në bazë të pranimit të fajit, në të cilin me shqiptimin e sanksionit penal ndaj të akuzuarit, i dëmtuari sipas nenit 114 të Ligjit për procedurë penale, udhëzohet në kontest.

Megjithatë, edhe pse veprim i këtillë i gjykatave të shkallës së parë, gjatë vendimmarrjes së aktgjykimit në bazë të pranimit të fajit është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë procedurën për miratim të aktgjykimit në bazë të pranimit të fajit, i dëmtuari është prezent në seancën e diskutimit kryesor, por nuk merret në pyetje dhe i njëjti nuk prononcohet lidhur me kërkesën pronësore juridike dhe në qoftë se nuk është prezent dhe nëse nuk është ftuar në mënyrë të rregullt në seancën kryesore, nuk nxirret provë – procesverbal për marrje në pyetje të të dëmtuarit në procedurë paraprake para prokurorit publik dhe atë në pjesën, në të cilën është prononcuar mbi kërkesën juridike pronësore.

Për shkak të së theksuarës, i dëmtuari nuk mund ta realizojë të drejtën e tij për kompensim mbi kërkesën juridike pronësore në procedurën penale që zhvillohet ndaj të akuzuarit, në kuptim të nenit 114 të Ligjit për procedurë penale, para se gjithash për vepra penale, te të cilat dëmi është element kualifikues i esencës ligjore të veprës penale, ku në aktgjykimin është caktuar saktë vlera e dëmit dhe i dëmtuari ka të drejtë që t'i shqiptohet kërkesa juridike pronësore dhe gjykata sipas nenit 114 paragrafi 2 të Ligjit për procedurë penale, ka për obligim të vendos për kërkesën juridike pronësore.

Në Ligjin për procedurë penale, janë paraparë kushtet kur i dëmtuari mund të udhëzohet që kërkesën juridike pronësore ta realizojë në kontest.

Nga ana tjetër, nëse i dëmtuari nuk paraqet kërkesë juridike pronësore ndaj të akuzuarit, në atë rast ekziston detyrimi për zbatimin e institutit – Konfiskim i pronës dhe përfitimit pronësor, sipas nenit 97 të Kodit penal, ngase askush nuk mund ta mbajë përfitimin pronësor drejtpërdrejtë apo indirekt, të siguruar me veprën penale dhe në rastin kur i dëmtuari nuk paraqet kërkesë juridike pronësore – kompensim të dëmit, përfitimi pronësor duhet të konfiskohet nga i akuzuari në interes të shtetit.

Duke marrë parasysh të sipër theksuarën, në lëndët të cilat miratohen aktgjykime në bazë të pranimit të fajit, ku të dëmtuarit për kërkesën juridike pronësore udhëzohen në kontest, të njëjtët lidhur me kërkesën juridike pronësore pa fajin e tyre nuk mundën që në procedurë penale ta realizojnë kërkesën e tyre juridike pronësore, edhe pse është caktuar saktë se edhe dëmi paraqet element kualifikues dhe të rëndësishëm të esencës ligjore të veprës penale, që krijojnë shpenzime shtesë për të dëmtuarit.

Në procedurë ankuese, nuk ka mundësi që gjykata e shkallës së dytë të intervenojë në këtë pjesë të aktgjykimit, duke qenë se në rastin kur është parashtruar ankesë nga i dëmtuari, ndërsa kërkesa juridike pronësore nuk është shqiptuar në procedurën penale në gjykatën e shkallës së parë, ankesa e të dëmtuarit është e pa lejuar, ngase i njëjti sipas nenit 411 paragrafi 4 të Ligjit për procedurë penale, mund të parashtrrojë ankesë, lidhur me kërkesën juridike pronësore vetëm nëse e njëjta është shqiptuar.

Nga këtu, gjykata mund që të dëmtuarin ta udhëzojë në kontest, vetëm nëse kërkesa juridike pronësore është e bazuar, por nuk ka prova. Krejtësisht tjetër është situata, nëse me konstatimin e kërkesës juridike pronësore dukshëm do të zgjaste procedura. Po ashtu, gjykata të dëmtuarin do ta udhëzonte në kontest nëse kërkesa juridike pronësore është e pabazë, që konstatohet nga faktet dhe provat në procedurë.

Duke marrë parasysh të theksuarën, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut konstaton se, kur kushtet për shqiptimin e kërkesës juridike pronësore plotësohen, përkatësisht kur i dëmtuari ka paraqitur kërkesë juridike pronësore dhe në procedurën e gjykatës së shkallës së parë nuk do të thirret i dëmtuari, ose ka ardhur dhe nuk është marrë në pyetje dhe nuk janë nxjerrë prova për kërkesën e dëmit, të cilat ekzistojnë në shkresat e lëndës, kurse dëmi është element kualifikues i esencës ligjore të veprës penale dhe është miratuar aktgjykim në bazë të pranimit të fajit, ku nuk është vendosur për kërkesën juridike pronësore, gjykata më e lartë drejtpërdrejtë me detyrë zyrtare mund ta abrogojë aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave të procedurës penale nga neni 415 paragrafi 1 pika 11 të Ligjit për procedurë penale, ngase gjykata duhet të miratojë vendim për kompensim të dëmit për të dëmtuarin ose ta ndryshojë sipas detyrës zyrtare nëse disponon me prova në atë drejtim.

Kjo, do të thotë se nuk ka vlerësim diskret të gjykatës nëse do të vendos mbi kërkesën për kompensim të dëmit, ose të dëmtuarin do ta udhëzojë në kontest.

Kur i dëmtuari nuk ka paraqitur kërkesë juridike pronësore, ekziston detyrim për zbatimin e institutit – Konfiskim i pronës dhe përfitimit pronësor, sipas nenit 97 të Kodit penal.

Gjatë vendimmarrjes, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut i ka pasur parasysh edhe standardet ndërkombëtare lidhur me aspektet kryesore për konfiskim të pronës ose përfitimit pronësor të siguruara me vepër penale edhe atë: Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar trans nacional nga dhjetori i vitit 2000, Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit nga viti 2005, instrumente të Këshillit të Evropës edhe atë Konventën për larje të parave, për zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e përfitimit pronësor nga krimi dhe për financim të terrorizmit nga vitit 2005 (ETS nr.198) “Konventën e Varshavës”, si dhe instrumente të Unionit Evropian – Direktiva e 2014/42/UE nga viti 2014 (“Direktiva e vitit 2014”).

SEKTORI I VEPRAVE PENALE